



Prishtinë, më 30 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1148/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI13/17

Parashtrues

Bedri Prishtina dhe Fahri Bekteshi

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 3442/2016, i 10 tetorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Surøy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gérxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Bedri Prishtina dhe Fahri Bekteshi nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kérkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 3442/2016, të 10 tetorit 2016, të cilin parashtruesit e kanë pranuar më 20 tetor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesit pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] nenin 24 [Barazia para ligjit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [E Drejta e Pronës] dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 shkurt 2017, parashtruesit nëpërmjet postës e dorëzuan kérkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 20 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës, me vendim, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegin shqyrta, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Selvete Gérxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 12 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kérkesës dhe i dërgoi një kopje të kérkesës Gjykatës së Apelit.
8. Më 4 korrik 2017, Kolegi shqyrta e shqyrtoi reportin e gjyqtarit rapportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

Përbledhja e fakteve

9. Më 8 korrik 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin C. nr. 3216/2014, refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesve për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën kanë kerkuar që t'i ndalohet të paditurit - kundërshtarit të sigurimit M. Zh., të lidhë çfarëdo kontrate me persona tjerë, ta ngarkojë me hipotekë ose ndonjë ngarkesë tjetër reale ose detyrimore ose të ndërmarrë veprime me të cilat do ta ndryshojë strukturën e pronës së paluajtshme e cila është objekt i kontestit pronësor në sipërfaqen në ngastrat kadastrale të cekura si në propozim, deri në vendosjen e mendimit meritor sipas kérkesës së paditësit.

10. Në një datë të paspecifikuar, kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, i autorizuari i parashtruesve ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
11. Më 10 tetor 2016, Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktvendimin CA. nr. 3442/2016, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesve, ndërsa Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë e ka vërtetuar.
12. Më 28 tetor 2016, parashtruesit nëpërmjet të autorizuarit të tyre në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, paraqiten kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit.
13. Më 7 nëntor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me njoftimin KMLC nr. 73/16, njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesve se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është aprovuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se e drejta për gjykim të drejtë dhe të pa anshëm e garantuar me Kushtetutë (neni 31) dhe e drejta për proces të rregullt gjyqësor e garantuar me KEDNJ (neni 6) janë shkelur për shkak të cenimit të parimit të barazisë së palëve në procedurë (barazia e armëve) dhe atë sepse provat e paraqitura nga palët nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë nga gjykatat e rregullta dhe, për më tepër, vendimet gjyqësore nuk janë mjaftueshëm të arsyetuara.
15. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu, kanë pohuar se e drejta në pronë u është shkelur si pasojë e këtij procesi gjyqësor të paanshëm, duke theksuar se gjendja faktike është konstatuar jo e plotë dhe e gabuar sikurse që edhe ligji në fuqi është aplikuar gabimisht.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesve, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesit i kanë përbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Më tej, Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

19. Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- “Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
- 1. (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
- dhe*
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
- (...)*
- (d) Parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
20. Lidhur me si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa është parashtruar sipas nenit 113 të Kushtetutës brenda afateve të parapara me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterjes së mjeteve juridike në këtë fazë të procedurës gjyqësore. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse janë përbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës.
21. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të paragrafit 1, të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse me vendimet e kontestuara ishte refuzuar kërkesa për masë të sigurisë nga gjykatat e rregullta dhe për pasojë kishte edhe shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
22. Gjykata vë në pah se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës “*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)*”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe të KEDNJ-së lidhur me rastin ashtu sikur janë paraqitur nga parashtruesit

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 6 i KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt]

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësish, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e Gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrale nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëherëshëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.
23. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih në mes tjerash *mutatis mutandis Edwards kundër Mbretërisë së bashkuar* 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247 dhe B. *Vidal* kundër *Belgikës*, 22 prill 1992. f. 33, seria A. nr. 235)
24. Lidhur me si më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesit kanë kërkuar të vlerësohet nëse nenin 31 i Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së janë shkelur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, CA. nr. 3442/2016, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesve lidhur me aplikimin e masës së sigurisë për një pronë e cila përndryshe është objekt i një kontesti pronësor ndërmjet parashtruesve dhe palëve kundërshtare në atë proces dhe për të cilën nuk ka akoma një vendim përfundimtar lidhur me kontestin kryesor.
25. Lidhur me si më sipër, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin C. nr. 3216 /17, të 8 korrikut 2016 kishte refuzuar propozimin e parashtruesve për aplikimin e masës së sigurisë ndaj kundër propozuesve,

ndërsa në pikën II të këtij aktvendimi Gjykata Themelore kishte anuluar vendimin e mëhershëm të po kësaj gjykate për aplikimin e masës së përkohshme ndaj kundër propozuesit SHPK "Viva" të vendosur më 12 dhjetor 2014.

26. Duke arsyetuar aktvendimin si më sipër, Gjykata Themelore kishte theksuar, në mes tjerash "*Me nenin 297 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, është e paraparë se "Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, apo në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundëson apo vështirëson dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit".*
27. Gjykata Themelore më tej ka arsyetuar se "*Provat të cilat i ka paraqitur propozuesi i masës së sigurisë për ta mbështetur kërkesën janë kundërthënëse dhe në asnjë mënyrë nuk e bëjnë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive".*
28. Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar kishte arsyetuar: "*Duke i vlerësuar pretendimet ankimore si dhe procedurën që është mbajtur në lidhje me caktimin e masës së sigurimit, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë me aplikimin e drejtë të LPK-së me të cilin janë paraparë kushtet për caktimin e masës së sigurimit e ka nxjerrë aktvendimin e cila është theksuar në diapositivin e aktvendimit. Kjo për shkak se caktimi i masës se sigurimit nënkuption vërtetimit' esencial të gjendjes faktike deri te shkalla e besueshmërisë se ekziston rreziku se i padituri do t'ia pamundësoj ose do t'ia vështirësoj dukshëm realizimin' e kërkesëpadisë.*"
29. Më tej, në aktvendim kishte theksuar gjithashtu "*Kjo nënkuption se provat administrohen vetëm rrëth caktimit të masës a para së gjithave nuk shterohen të gjitha provat, sepse kjo do të nënkuptonte se gjendja faktike në tërësi është shqyrtuar përkatësisht se procedura është pjekur për vendosjen meritore. Andaj, kjo gjykatë nuk i ka arsyetuar në mënyrë te veçantë pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me lëndën e kërkesëpadisë, sepse kjo do të zgjidhet sipas çështjes kryesore.*"
30. Gjykata, më tej konstaton se parashtruesit edhe pse e kishin bashkëngjitur në kërkesë njoftimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, KMLC 73/16, parashtruesit as e kishin kontestuar e as kishin pretenduar ndonjë shkelje kushtetuese me këtë akt juridik andaj, Gjykata nuk do të vlerësojë përputhshmërinë e këtij akti me Kushtetutën.
31. Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit, refuzoi ankesën e parashtruesve kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore dhe rrjedhimisht, refuzoi edhe kërkesën për vendosjen e masës së sigurisë të kërkuar nga parashtruesit.
32. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përvèc

dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, éshtë roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, parografi 28).

33. Lidhur me si më sipër, Gjykata vëren se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë vlerësuar gjendjen faktike të rastit dhe kanë adresuar në tërësi pretendimet e parashtruesve lidhur me kërkesën e tyre dhe kanë dhënë arsyetim të bazuar në ligj dhe të mjaftueshëm lidhur me pretendimet e ngritura.
34. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesve u janë ofruar mundësi të jenë aktiv në të gjitha fazat e procedurës dhe gjithashtu parashtruesit kanë ushtruar mjetin juridik të ankesës, andaj nga aspekti i kushtetutshmërisë Gjykata nuk gjen se vendimet gjyqësore të jenë arbitrarë apo të jenë tregues të shkeljes të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë.
35. Në rrethanat e rastit, roli i Gjykatës Kushtetuese éshtë që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 16 shtatorit 1996, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, para. 65, shih po ashtu, *mutatis mutandis*, rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
36. Duke marrë parasysh faktin se procedura gjyqësore lidhur me çështjen e përcaktimit të titullit të pronësisë akoma nuk ka përfunduar por éshtë vendosur vetëm lidhur me masën e kërkuar të sigurisë, Gjykata në këtë fazë nuk mund të vlerësojë pretendimin mbi shkeljen eventuale të së drejtës në pronë, sipas nenit 46 të Kushtetutës.
37. Si përbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës asgjë nuk i ndalon që pas përfundimit të procedurës gjyqësore në tërësi eventualisht të paraqesin një kërkesë të re në Gjykatën Kushtetuese, por në këtë fazë të procedurës sa i përket objektit të kërkesës ata nuk kanë paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat para Gjykatës së Apelit kanë paraqitur në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës për mbrojtjen e pronës, dhe rrjedhimisht nuk kanë mbështetur mjaftueshëm me dëshmi pretendimet e tyre.
38. Gjykata, bazuar në vlerësimet e mësipërme, konstaton se kërkesa lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së dhe me nenin 46 të Kushtetutës, në formën se si éshtë paraqitur nga parashtruesit, éshtë qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1 dhe 2) (d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 4 korrik 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues

Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

